




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 246/2019

Datë: 12 dhjetor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12 dhe 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 227- të, të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Përmbytjes për ueb faqen e gjyqësorit të Kosovës.
- II. Obligohen gjykatat dhe Sekretariati i KGJK-së, për zbatimin këtyre Procedurave Standarde të Veprimit.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 12 dhjetor 2019.


A R S Y E T I M

Përditësimi i rregullt dhe zhvillimi i përmbytjes relevante është me interes si për publikun ashtu edhe për gjyqësorin dhe ka një rol të rëndësishëm në transparencën, qasjen dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve.

Deri më tani, gjyqësori në Kosovë ka hasur vështirësi në këtë aspekt dhe këtu ka kontribuar edhe mungesa e qartësisë mbi kriteret kryesore për publikim të përmbytjes, rolet dhe afatet.

Dokumenti me Procedurat Standarde të Veprimit krijon një kornizë, deri tani të munguar, e cila ndihmon në mirëmbajtjen e vazhdueshme të përmbytjes dhe parashton kriteret kyçe, rolet si dhe afatet e rregullta për mirëmbajtjen e përmbytjes kryesore që publikohet në ueb faqe.

Andaj, duke u bazuar nga ajo që u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Skender ÇOÇAJ,

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të KGJK-së;
- Arkivit.